



| | | | |
|--|-------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Pranimar / Dorezuar Prijemno / Predato Received / Delivery | 26 - 12 - 2023 | 3 | viti god year |
| Organ / Ujësia Org / Unit | Nr Prot Br Prot Prot No | Shtojta Prilog Appendix | Sasia Kolicitë Quantity |
| SKAJMESHICK | 7671/2023 | | 1/8 |



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1338/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Kaltrina Avdullahi-Prenaj -Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1338/2023 të datës 27.10.2023 të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, në çështjen juridike "Kërkesë nga Marrëdhënia e Punës", duke vepruar në pajtim me nenin 16 paragrafin 3 ,nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 26.12.2023, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET POSHTË si e palejuar ankesa me numër A.nr.1338/2023 e datës 27.10.2023 e parashtruar nga ankuesi.

A r s y e t i m

Ankuesi në Ministrinë e Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit sipas Akt Emërimit me numër Nr.4/4-1 të datës 21.02.2019 në pozitën e punës „Zyrtar për arkiv“ në kuadër të Departamentit të Financave dhe Shërbime të Përgjithshme, më datë 29.05.2020 U.D i Sekretarit të Përgjithshëm ka nxjerr Vendimin me numër Nr.2-853 përmes së cilit ankuesin e ka emëruar Ushtrues i Detyrës së Udhëheqësit të Divizionit për Teknologji, ndërsa më datë 29.09.2023 Sekretarja e Përgjithshme në Ministrinë e Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit ka nxjerr Vendimin me numër Nr.2-2413 përmes së cilit e ka shfuqizuar Vendimin me numër Nr.2-853 të datës 29.05.2020 duke e kthyer ankuesin në pozitën e punës sipas Akt Emërimit të datës 01.10.2023.

I pakënaqur me Vendimin me numër Nr.2-2413 të datës 29.09.2023, të Sekretares së Përgjithshme në Ministrinë e Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, ankuesi më datë 27.10.2023 ka

parashtruar ankesë me numër protokoli 6708/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke kërkuar anulimin e Vendimit me numër Nr.2-2413 të datës 29.09.2023 duke e lënë në fuqi Vendimin me numër Nr.2-853 të datës 29.05.2020, e gjithashtu ti aprovohet edhe puna shtesë sipas Vendimit me numër Nr.2-01 të datës 01.01.2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 09.11.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit tek organi i punësimit Ministria e Shkencës Arsimit, Teknologjisë dhe Inovacionit, ndërsa kjo e fundit më datë 24.11.2023 ka dërguar përgjigje në ankesë me numër protokoli 1338/2023 së bashku me shkresat e lëndës.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me Vendimin me shifër: VK/2023 dhe numër protokoli Nr.prot.7412/2023 të datës 11.11.2023 ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës me numër A.nr.1256/2023 edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me nr. Protokoli 6708/2023 të parashtruar më datë 27.10.2023 nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin e Pavarur të Kosovës; Vendimin me numër Nr.2-2413 të datës 29.09.2023; Vendimin me numër Nr.2-2414 të datës 29.09.2023; Vendimin me numër Nr.2-853 të datës 29.05.2020; Kërkesën për emërimin e U.D Udhëheqës i Div. të Logjistikës të datës 29.05.2020; E-mailin e datës 29.05.2020; Dëshminë e Librit Intern; Kërkesën për angazhim me pagesë për punën shtesë jashtë orarit të punës për periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2021 të datës 01.01.2021; Vendimin me numër Nr. 2-01 të datës 01.01.2021; ; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë Drejtues i mesëm për vitin 2020 të datës 28.12.2020; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë Drejtues i mesëm për vitin 2021 të datës 30.12.2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë Drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional për vitin 2022 të datës 31.01.2023; Kërkesa për pagesën e orëve të punës shtesë (vikendeve), të kryera brenda muajve: Janar-Shkurt-Mars-Prill të vitit-2021 të datës 05.12.2022; Kërkesa për pagesën e orëve të punës shtesë (vikendeve), të kryera brenda muajve: Janar-Shkurt-Mars-Prill të vitit-2021 të datës 13.05.2022; Vendimin me numër Nr. 252/2-5 me datë 07.04.2010; Kërkesa për pagesën e orëve të punës shtesë (vikendeve), të kryera brenda muajve: Janar-Shkurt-Mars-Prill të vitit-2021 të datës 05.12.2022; Kërkesa për pagesën e orëve të punës shtesë (vikendeve), të kryera brenda muajve: Janar-Shkurt-Mars-Prill të vitit-2021 të datës 26.04.2021; Tabela me orë të llogaritura për muajin Janar të vitit 2021; Raporti i prezencës në punë për datën: 02/01/2021; Raporti i prezencës në punë për datën: 03/01/2021; Raporti i prezencës në punë për datën: 09/01/2021; Raporti i prezencës në punë për datën: 16/01/2021; Raporti i prezencës në punë për datën: 17/01/2021; Raporti i prezencës në punë për datën: 23/01/2021; Raporti i prezencës në punë për datën: 30/01/2021; Tabela me orë të llogaritura për muajin Shkurt të vitit 2021; Raporti i prezencës në punë për datën: 06/02/2021; Raporti i prezencës në punë për datën: 07/02/2021; Raporti i prezencës në punë për datën: 13/02/2021; Raporti i prezencës në punë për datën: 14/02/2021; Raporti i prezencës në punë për datën: 20/02/2021; Raporti i prezencës në punë për datën: 21/02/2021; Raporti i prezencës në punë

0-1
D-14
Shk. Nr. 07/1

për datën: 27/02/2021; Raporti i prezencës në punë për datën: 28/02/2021; Tabela me orë të llogaritura për muajin Mars të vitit 2021; Raporti i prezencës në punë për datën: 06/03/2021; Raporti i prezencës në punë për datën: 07/03/2021; Raporti i prezencës në punë për datën: 13/03/2021; Raporti i prezencës në punë për datën: 14/03/2021; Raporti i prezencës në punë për datën: 20/03/2021; Raporti i prezencës në punë për datën: 21/03/2021; Raporti i prezencës në punë për datën: 27/03/2021; Raporti i prezencës në punë për datën: 28/03/2021; Tabela me orë të llogaritura për muajin Prill të vitit 2021; Raporti i prezencës në punë për datën: 03/04/2021; Raporti i prezencës në punë për datën: 04/04/2021; Raporti i prezencës në punë për datën: 10/04/2021; Raporti i prezencës në punë për datën: 11/04/2021; Raporti i prezencës në punë për datën: 17/04/2021; Raporti i prezencës në punë për datën: 18/04/2021; Raporti i prezencës në punë për datën: 24/04/2021; Raporti i prezencës në punë për datën: 25/04/2021; Kërkesën për kompensimin e punës shtesë me pagesë që është kryer brenda muajve: Janar-Shkurt-Mars-Prill-Gusht-Shtator-Tetor-Nëntor dhe Dhjetor të vitit 2022, gjatë ditëve të vikendit për arkivimin dhe mirëmbajtjen e lëndëve të divizionit të financave, pagesat që përfundohen dhe sigurimin e lëndëve Auditorëve dhe Policisë së Kosovës sipas kërkesave të tyre dhe sipas kërkesës së thesarit MFT të datës 05.12.2022; Kërkesën për kompensimin me pagesë për punën e kryer shtesë jashtë orarit të punës brenda Janar-Shkurt-Mars- Prill të vitit 2022, gjatë ditëve të vikendit për arkivimin dhe mirëmbajtjen e lëndëve të divizionit të financave, pagesat që përfundohen dhe sigurimin e lëndëve Auditorëve dhe Policisë së Kosovës sipas kërkesave të tyre dhe sipas kërkesës së thesarit MFT të datës 26.09.2022; Vendimin me numër Nr. 252/2-5 të datës 07.04.2010; Tabela me orë të llogaritura për muajin Janar të vitit 2022; Raporti i prezencës në punë për datën: 03/01/2022; Raporti i prezencës në punë për datën: 08/01/2022; Raporti i prezencës në punë për datën: 09/01/2022; Raporti i prezencës në punë për datën: 15/01/2022; Raporti i prezencës në punë për datën: 22/01/2022; Raporti i prezencës në punë për datën: 23/01/2022; Raporti i prezencës në punë për datën: 29/01/2022; Raporti i prezencës në punë për datën: 30/01/2022; Tabela me orë të llogaritura për muajin Shkurt të vitit 2022; Raporti i prezencës në punë për datën: 05/02/2022; Raporti i prezencës në punë për datën: 12/02/2022; Raporti i prezencës në punë për datën: 13/02/2022; Raporti i prezencës në punë për datën: 19/02/2022; Raporti i prezencës në punë për datën: 20/02/2022; Raporti i prezencës në punë për datën: 26/02/2022; Tabela me orë të llogaritura për muajin Mars të vitit 2022; Raporti i prezencës në punë për datën: 05/03/2022; Raporti i prezencës në punë për datën: 06/03/2022; Raporti i prezencës në punë për datën: 12/03/2022; Raporti i prezencës në punë për datën: 19/03/2022; Tabela me orë të llogaritura për muajin Prill të vitit 2022; Raporti i prezencës në punë për datën: 02/04/2022; Raporti i prezencës në punë për datën: 03/04/2022; Raporti i prezencës në punë për datën: 09/04/2022; Raporti i prezencës në punë për datën: 10/04/2022; Raporti i prezencës në punë për datën: 16/04/2022; Raporti i prezencës në punë për datën: 23/04/2022; Raporti i prezencës në punë për datën: 24/04/2022; Raporti i prezencës në punë për datën: 26/04/2022; Raporti i prezencës në punë për datën: 30/04/2022; Tabela me orë të llogaritura për muajin Gusht të vitit 2022; Raporti i prezencës në punë për datën: 13/08/2022; Raporti i prezencës në punë për datën: 20/08/2022; Raporti i prezencës në punë për datën: 27/08/2022; Raporti i prezencës në punë për datën: 28/08/2022; Tabela me orë të llogaritura për muajin Shtator të vitit 2022; Raporti i prezencës në punë për datën: 03/09/2022; Raporti i prezencës në punë për datën: 04/09/2022; Raporti i prezencës në punë për datën: 10/09/2022; Raporti i prezencës në punë për datën: 11/09/2022; Raporti i prezencës në punë për datën: 17/09/2022; Raporti i prezencës në punë për datën: 18/09/2022; Raporti i prezencës në punë

për datën: 24/09/2022; Raporti i prezencës në punë për datën: 25/09/2022; Tabela me orë të llogaritura për muajin Tetor të vitit 2022; Raporti i prezencës në punë për datën: 01/10/2022; Raporti i prezencës në punë për datën: 02/10/2022; Raporti i prezencës në punë për datën: 15/10/2022; Raporti i prezencës në punë për datën: 16/10/2022; Raporti i prezencës në punë për datën: 29/10/2022; Raporti i prezencës në punë për datën: 30/10/2022; Tabela me orë të llogaritura për muajin Nëntor të vitit 2022; Raporti i prezencës në punë për datën: 05/11/2022; Raporti i prezencës në punë për datën: 06/11/2022; Raporti i prezencës në punë për datën: 12/11/2022; Raporti i prezencës në punë për datën: 13/11/2022; Raporti i prezencës në punë për datën: 19/11/2022; Raporti i prezencës në punë për datën: 20/11/2022; Raporti i prezencës në punë për datën: 26/11/2022; Raporti i prezencës në punë për datën: 28/11/2022; Raporti i prezencës në punë për datën: 05/11/2022; Kërkesën për kompensimin e punës shtesë me pagesë që është kryer brenda muajve: Janar-Shkurt-Mars-Prill-Gusht-Shtator-Tetor-Nëntor dhe Dhjetor të vitit 2022, gjatë ditëve të vikendit për arkivimin dhe mirëmbajtjen e lëndëve të divizionit të financave, pagesat që përfundohen dhe sigurimin e lëndëve Auditorëve dhe Policisë së Kosovës sipas kërkesave të tyre dhe sipas kërkesës së thesarit MFT të datës 06.02.2023; Kërkesën për kompensimin e punës shtesë jashtë orarit të punës për z. [] për periudhën kohore Gusht-Shtator-Tetor-Nëntor dhe Dhjetor të vitit 2022, për arkivimin dhe mirëmbajtjen e lëndëve të divizionit të financave, pagesat që përfundohen dhe sigurimin e lëndëve Auditorëve dhe Policisë së Kosovës sipas kërkesave të tyre dhe sipas kërkesës së thesarit MFT të datës 26.09.2022; Tabela me orë të llogaritura për muajin Dhjetor të vitit 2022; Raporti i prezencës në punë për datën: 03/12/2022; Raporti i prezencës në punë për datën: 04/12/2022; Raporti i prezencës në punë për datën: 10/12/2022; Raporti i prezencës në punë për datën: 11/12/2022; Raporti i prezencës në punë për datën: 17/12/2022; Raporti i prezencës në punë për datën: 18/12/2022; Raporti i prezencës në punë për datën: 25/12/2022; Raporti i prezencës në punë për datën: 26/12/2022; Raporti i prezencës në punë për datën: 31/12/2022; Raporti i prezencës në punë për datën: 01/04/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 02/04/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 08/04/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 09/04/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 10/04/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 11/04/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 15/04/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 16/04/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 22/04/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 23/04/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 19/03/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 18/03/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 29/04/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 30/04/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 01/05/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 06/05/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 07/05/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 09/05/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 13/05/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 14/05/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 20/05/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 27/05/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 28/05/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 03/06/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 04/06/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 10/06/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 11/06/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 17/06/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 24/06/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 25/06/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 01/07/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 02/07/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 08/07/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 09/07/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 15/07/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 16/07/2023; Raporti i prezencës në punë

për datën: 22/07/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 05/08/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 06/08/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 12/08/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 13/08/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 19/08/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 20/08/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 26/08/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 02/09/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 03/09/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 09/09/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 10/09/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 16/09/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 23/09/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 24/09/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 30/09/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 01/01/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 02/01/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 03/01/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 07/01/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 08/01/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 09/01/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 14/01/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 15/01/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 04/02/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 05/02/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 11/02/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 17/02/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 19/02/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 25/02/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 26/02/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 04/03/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 05/03/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 11/03/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 12/03/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 18/03/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 19/03/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 25/03/2023; Raporti i prezencës në punë për datën: 26/03/2023; Vendimin VK/2023 me numër protokolli 7412/2023 të datës 11.12.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke i shqyrtuar shkresat e lëndës ka konstatuar që ankesa e ankuesit, është e palejuar, **SEPSE**:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në provat që gjenden në shkresat e lëndës, ka konstatuar se U. D. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit me datë 29.05.2020 ka nxjerrë Vendimin me numër Nr.2-853 të datës 29.05.2020 përmes së cilit ankuesi është emëruar si Ushtrues Detyre i Divizionit për Teknologji Informative dhe Shërbime Logjistike si dhe Vendimin me numër Nr.2-01 të datës 01.01.2021 për lejimin e punës shtesë jashtë orarit të punës për ankuesin ne pozitën e Ushtruesit të Detyrës së Divizionit për Teknologji Informative dhe Shërbime Logjistike .

Ankuesi i punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit sipas Akt Emërimit me numër Nr.4/4-1 të datës 21.02.2019 në pozitën e punës „Zyrtar për arkiv“ në kuadër të Departamentit të Financave dhe Shërbime të Përgjithshme, me datë 27.10.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me numër protokolli 6708/2023, kundër Vendimit me numër Nr.2-2413 të datës 29.09.2023, të Sekretares së Përgjithshme në Ministrinë e Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, me pretendime ankimore se vendimi është nxjerrë në kundërshtim me ligjin në fuqi, gjegjësisht me shfuqizimin e Vendimit të lartpërmendur janë shkelur dispozitat materiale dhe dispozitat procedurale po ashtu ai kërkon kompensimin në mënyrë retroaktive për punën shtesë dhe punën jashtë orarit të punës sipas Vendimit me numër Nr.2-01 të datës 01.01.2021.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 27 paragrafin 3 të Ligjit Nr.08/L-197 Për Zyrtarët Publik konstaton se çdo nëpunës civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji...". Ndërlidhur më këtë, neni 13 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ka përcaktuar se: *"Përveç kur përjashtohet shprehimisht me ligj, secili person ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative dhe ato gjyqësore, në mënyrën e përcaktuar me ligj, kundër një veprimi apo mosveprimi administrativ të organit publik që i cenon një të drejtë që i është shkelur apo cenuar ndonjë e drejtë e tij nga marrëdhënia e punës me apo një interes juridik, ndërsa neni 125 paragrafi 1 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative përcakton se: "1. Përpos nëse është paraparë ndryshe me ligj, ankesa mund të parashtrohet kundër një akti administrativ apo ndaj mosveprimit të organit publik brenda afatit të përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative (në vijim: heshtja administrative)"* pastaj me dispozitat e nenit 127 paragrafi 4 i po këtij ligji ka përcaktuar se: *"Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ"*. Përkatësisht sipas këtyre dispozitave ligjore rezultoi se çdo nëpunës civil i cili pretendon një veprim administrativ (akt administrativ) apo mos veprim (heshtjes administrative) të organit gjegjes të punësimit, ka të drejtë të parashtror ankesë drejtpërdrejt në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Në kuptim të pranueshmërisë së ankesës së ankuesit, Kolegji i Këshillit pasi ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të dërguara nga ana e organit të punësimit dhe ankuesi, nuk ka gjetur dëshmi se ankuesi ka parashtruar ankesë deri më tani në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës lidhur me kompensimin për punën shtese dhe punën jashtë orarit të punës sipas Vendimit me numër Nr.2-01 të datës 01.01.2021. Kështu që në vlerësim të Kolegjit ankesa e ankuesit me numër të protokollit 6708/2023 e datës 27.10.2023 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është e parashtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafit 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data kur është njoftuar për aktin administrativ"*, si dhe neni 127 paragrafit 4 me të cilin parashihet se: 4. *Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ"*, andaj Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka vlerësuar se ankuesi nuk e ka shfrytëzuar të drejtën e ankimit brenda afateve ligjore sipas dispozitave të lartpërmendura në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës. Prandaj në kuptim të kësaj dhe nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ankesa e ankuesit lidhur me pretendimin për kompensimin në mënyrë retroaktive për punën shtese dhe punën jashtë orarit të punës sipas Vendimit me numër Nr.2-01 të datës 01.01.2021 është e pa lejuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, po ashtu ka analizuar dispozitat ligjore me rastin e caktimit të ankuesit në pozitën e Ushtruesit të Detyrës së Divizionit për Teknologji Informativ dhe Shërbime Logjistike në MASHT nga e cila pozitë është larguar tash dhe që është objekt i kësaj ankese dhe bazuar në provat që ndërlidhen me këtë çështje ka konstatuar se ankuesi ishte caktuar Ushtrues i Detyrës së Divizionit për Teknologji Informativ dhe Shërbime Logjistike më datë 29.05.2020 bazuar në dispozitat e nenit 30 paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ndërlidhur me këtë çështje kolegji konstaton se ankuesi këtë pozitë e kishte mbajtur deri më datë 29.09.2023 respektivisht me gjatë se tre (3) muaj përkundër që Vendimi i datës 29.05.2020 mbi të cilin kishte kryer detyrën e Ushtruesit të Detyrës së Divizionit për Teknologji Informativ dhe Shërbime Logjistike ishte bazuar në nenin 30 paragrafin 4 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (i aplikueshëm në kohën kur është emëruar ankuesi si ushtrues detyre) ku ka përcaktuar se „ 4. Në rast të mbetjes së një pozite të lirë në shërbimin civil, ushtruesi i detyrës nuk mund të emërohet më gjatë se tre (3) muaj”, si dhe për faktin se kjo pozitë është e lirë dhe se procedura e plotësimit të kësaj pozite duhej të bëhej në pajtim me nenin 124 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përcaktohet legjitimitimi, shkaqet dhe mjetet juridike administrative, ndërsa paragrafi 1 i këtij neni përcakton që: *“1.Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim.....”*, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se vendimi i kontestuar me ankesë nuk cenon ndonjë të drejtë apo interes të ligjshëm të ankuesit, për faktin se ankuesi mbanë pozitën që kishte sipas Akt Emërimit, duke pasur parasysh dispozitat ligjore që rregullojnë shërbimin civil përkatësisht Ligjin Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, se marrëdhënia e punës krijohet me aktin e nënshkrimit të akt emërimit dhe se çdo cenim i ndonjë të drejte që parashihet në këtë dokument zyrtarë/akt emërimit, i jep të drejtë secilit që atakohet në ndonjë formë përmes ndonjë veprimi administrativ që të ndërmer veprimet përkatësisht të përdorë mjetet juridike për të mbrojtur një të drejtë të caktuar që i garantohet me ligj, ndërsa në rastin konkretë kolegji i këshillit nuk ka hasur në ndonjë veprim që cenon interesin juridik nga marrëdhënia e punës së ankuesit, Kolegji i Këshillit, konstaton se është obligim ligjor që institucionet shtetërore me rastin e ushtruesve të detyrës për pozitën e liria të respektojnë dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë nga se çdo shmangie nga këto dispozita dhe legjislacionin tjetër që rregullon këtë çështje mund të rezultojë me pasoja juridike për institucionin përkatës, titullarin e të njëjtit dhe zyrtarët tjerë kompetentë, mbi këto baza ligjore të specifikuar si më lartë ankesa e ankuesit është e palejuar.

Bazuar në at që u tha si më lartë dhe duke iu referuar nenit 129 paragrafit 1 nën paragrafit 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar Vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1338/2023

Kaltrina Avdullahi-Prenaj


Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI



Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së